



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 21 Akti

Nr. 20 Vendimi

Tiranë më 04.06.2018

### V E N D I M

Trupa gjyqese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

**Brunilda Bekteshi**  
**Olsi Komici**  
**Lulzim Hamitaj**

Kryesuese  
Relator  
Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore Znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Theo Jacobs, në Tiranë, më datë 1 qershor 2018, ora 10:00 paradite, në Pallatin e Kongreseve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Marçela Shehu**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”; **Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; **Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; **Ligji nr. 49/2015** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” .

## **TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Marçela Shehu, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **VËREN:**

#### **FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, ushtron detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidate për Këshillin e Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (referuar më poshtë “Komisioni”). Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin e datës 14.12.2017, trupa gjyqese ka zgjedhur kryesuese për këtë çështje anëtarën Brunilda Bekteshi. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës gjyqese, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar Z. Theo Jackobs.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe 3) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të hetimit administrativ.

ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konkluduar se:

- 1. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- 2. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- 4. Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- 5. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

---

<sup>1</sup> Me shkresën me nr. 297/29, datë 13.11.2017, e përbërë nga 12 fletë, është dërguar raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar<sup>2</sup>, duke konkluduar mbi *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu”*.

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>3</sup> mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar se:

*“Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet janë të sakta dhe në përputhje me ligjin.*

*Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, për shkak të funksionit, apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.*

*Pasi u hetua raporti i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe denoncimet, nuk u gjetën indice apo elemente që mund të ngrinin dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.”*

Trupa gjyquese, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 21.05.2018 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Më datë 22.05.2018, subjektit të rivlerësimit iu bë e njohur përbërja e trupës gjyquese, si dhe u lajmërua se ka të drejtë të paraqesë pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutura nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupës.

## **QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Znj. Marçela Shehu ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*. Subjekti i rivlerësimit ka qenë

<sup>2</sup> Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 26.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 23.01.2018, dërgohet raporti i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, është gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt përfshiu: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Gjatë procedurës së rivlerësimit të subjektit janë administruar akte nga Ministria e Drejtësisë, KLD-ja, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, shoqëria (“\*\*\*\*”) sh.p.k., Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime Tiranë” sh.a., ALUIZNI, etj.

### **I. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë**

Në bazë të ligjit organik nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, relatori i çështjes ka kryer hetimin dhe vlerësimin e pavarur të të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjektet e së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

1. Pasuri e paluajtshme e llojit “shtëpi banimi”, me sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, kati i katërt, me adresë: Njësia Bashkiake Nr. (\*\*\*) , Rr. (“\*\*\*\*”), Tiranë. Pasuri në përdorim, jo në pronësi, e ndërtuar në vitin 1996 dhe e deklaruar për legalizim pranë ALUIZNI-t nga familjarët e bashkëshortit në shtator të vitit 2006, para lidhjes së martesës dhe para fillimit të detyrës së saj si gjyqtare. Subjekti është dekretuar si gjyqtare stazhiere në tetor 2006 ndërsa, sipas certifikatës së martesës lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile e Njesisë Bashkiake Nr. (\*\*\*) Tiranë, rezulton se ka lidhur martesë me shtetasin S. H më datë 24.09.2007<sup>4</sup>.

#### **❖ Hetimi i kryer nga Komisioni**

---

<sup>4</sup>Shiko në dosjen e Komisionit shkresën me nr. (\*\*\*) prot., datë 04.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë dhe përgjigjen e ardhur me shkresën me nr. (\*\*\*) prot., datë 19.01.2018, dhe shkresën me nr. (\*\*\*) prot., datë 23.01.2018, nga ku konstatohet se nuk ka pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

*Trupa gjyquese, mbështetur në korrespondencën e kryer me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t “Tirana-Veri”, nuk ka dyshime mbi këtë pasuri.*

*Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore. Vetëdeklarimi pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t “Tirana-Veri” është bërë nga shtetasit B. A. H. dhe Sh. A. H.<sup>5</sup>*

2. Pasuri e luajtshme, automjetet i markës “Mercedes-Benz”, tipi 204 c 200 CDI, me nr. shasje (\*\*\*) , e fituar me kontratën e shitblerjes nr. (\*\*\*) rep., (\*\*\*) kol., datë 10.08.2016, çmimi 6.000 (gjashtë mijë) euro. Pjesa takuese 50 %, në bashkëpronësi me bashkëshortin, si pasuri e vënë gjatë martesës<sup>6</sup>.

**Burimi i krijimit:** a) Të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Passat”, në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro, sipas kontratës me nr. (\*\*\*) rep., (\*\*\*) kol., datë 24.06.2016; b) Kursimet familjare.

#### ❖ **Hetimi i kryer i Komisionit**

U analizuan dokumentet:

- Kontratë shitblerjeje e automjetit “Mercedes-Benz”, tipi 204 c 200 CDI, me targë (\*\*\*) , nr. (\*\*\*) rep., (\*\*\*) kol., datë 10.08.2016, e lidhur para noterit publik I. H, me palë shitëse Z. A. A. dhe palë blerëse Znj. Marçela Shehu, me vlerë 6.000 (gjashtë mijë) euro;
- Kontratë shitjeje, datë 22.12.2015, shitësi (“\*\*\*\*”) sh.p.k., me NIPT (\*\*\*) , me adresë: autostrada Tiranë - Durrës, (\*\*\*) , (\*\*\*) , (\*\*\*) , Tiranë. Përfaqësuar nga administratori, Z. E. J, blerës Z. A. A për automjetin “Mercedes-Benz” C 200, bazuar në dokumentet e origjinës të Doganës Shqiptare, me çmim 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekë. Kjo shitje bazohet në faturën tatimore nr. (\*\*\*) , datë 22.12.2015;
- Kontratë shitblerjeje nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*) kol., datë 04.02.2010, e Zyrës së Noterisë Durrës, për shitjen e automjetit “Volkswagen”, tipi “3BG Passat”, nga shtetasi E. F dhe blerës Z. S. H, për shumën 5.200 (pesë mijë e dyqind) euro.
- Kontratë shitblerjeje për automjetin “Volkswagen”, tipi “3BG Passat”, me targë (\*\*\*) , nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*) kol., datë 24.06.2016, e lidhur para noterit publik I. H, me palë shitëse Z. S. H dhe palë blerëse Znj. E. S, me vlerë 5.000 (pesë mijë) euro.

Nga analiza e të dhënave të kontratave të mësipërme, ka logjikë ekonomike çmimi i blerjes së automjeteve nga shitësit dhe çmimi përkatës i shitjes, duke u justifikuar në këtë mënyrë burimi

<sup>5</sup>Shiko në dosje shkresën me nr. (\*\*\*) prot., datë 04.01.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t “Tirana - Veri” dhe përgjigjen e ardhur me nr. (\*\*\*) prot., datë 12.01.2018, (\*\*\*) prot., datë 08.03.2018, ku figurojnë shtetasit B. H. (vjehtëri) dhe Sh. H, si vetëdeklarues të godinës në proces legalizimi ku jeton subjekti.

<sup>6</sup>Shiko shkresën me nr. (\*\*\*) prot., datë 14.02.2018, nr. (\*\*\*) prot., datë 28.03.2018, drejtuar D.P.RR.SH. Transporteve dhe D.R. Transportit Tiranë dhe përgjigjet e ardhura me shkresat me nr. (\*\*\*) prot., datë 22.01.2018, dhe shkresa me nr. (\*\*\*) prot., datë 17.04.2018, ku konfirmohet pronësia e automjeteve për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur.

i të ardhurave për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”, tipi 204 c 200 CDI, nga subjekti i rivlerësimit, si dhe çmimi i blerjes prej 6.000 eurosh, duke marrë në konsideratë edhe të ardhurat nga pagat për vitin 2016, të subjektit dhe personit të lidhur, për mbulimin e diferencës së çmimit të blerjes së automjetit tip “Benz”, prej 1000 eurosh.

*Trupa gjyqesore nuk ka dyshime mbi këtë pasuri. Përputhet deklarimi i subjektit me verifikimin e kryer.*

### 3. Likuiditete

- i) Gjendje të ardhurash *cash* 1.350.000 ( një milion e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

**Burimi i krijimit:** Të ardhura nga bursa si studente në Shkollën e Magjistraturës dhe të ardhura nga puna në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Subjekti ka deklaruar gjendje mjetesh monetare *cash*:

- 700.000 lekë në Deklaratën e Pasurisë “Para fillimit të detyrës”;
- 500.000 lekë në Deklaratën vjetore të Pasurisë të vitit 2009;
- 200.000 lekë në Deklaratën vjetore të Pasurisë të vitit 2012;
- 200.000 lekë në Deklaratën vjetore të Pasurisë të vitit 2015;
- 1.350.000 lekë në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”.

#### ❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Në lidhje me deklarimin e gjendjes *cash*, para fillimit të detyrës në vitin 2006, në shumën 700.000 lekë, vit në të cilin subjekti ka deklaruar të blerë dhe një automjet në shumën 600.000 lekë, si burim krijimi, sipas subjektit, kanë shërbyer të ardhurat nga shkolla e Magjistraturës, si dhe nga punësimi.

Sipas analizës financiare të Komisionit, të ardhurat e subjektit para fillimit të detyrës kanë qenë 1.078.715 lekë, të ardhura këto që nuk e mbulojnë vlerën e blerjes së automjetit dhe gjendjen *cash* sepse, duke përlllogaritur edhe shpenzimet minimale jetike sipas të dhënave të INSTAT-it, krijohet një diferencë negative prej 632.221 lekësh (shpenzimet minimale duhen marrë me rezervë, sepse INSTAT-ti nuk ka publikuar të dhëna për vitet 2004 dhe 2005 e, për rrjedhojë, përlllogaritjet janë bërë në bazë të të dhënave të vitit 2006).

Për sa më lart, subjekti ka sqaruar se:

- a) Për blerjen e automjetit është ndihmuar edhe nga prindërit (subjekti në periudhën e deklarimit të pasurisë para fillimit të detyrës ka jetuar me prindërit në Shijak, Durrës);
- b) Për sigurimin e të ardhurave subjekti ka deklaruar se ka punuar me kohë të pjesshme, sipas mundësisë së subjektit dhe nevojave të televizionit për periudhën 1999 - 2003, pranë (“\*\*\*”), Shijak, dhe është shpërblyer në formë honorarësh, me pagesa për orë, që në total arrinin shumën 20.000 lekë në muaj. Televizioni nuk disponon dokumente në lidhje me pagesat e kryera për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, por edhe të

ndryshimeve që ka pësuar shoqëria ndër vite, si edhe për shkak se televizionit i është hequr licenca në vitin 2007.

Ky fakt vërtetohet edhe nga korrespondenca e kryer me (“\*\*\*\*”) Shijak, me shkresën kthim-përgjigje të protokolluar në Komision, me nr. (\*\*\*) prot., datë 24.04.2018.

Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes edhe disa fotografi, ku ajo duket në rolin e moderatores.

Në lidhje me shumën e kontribuar nga prindërit për blerjen e automjetit dhe gjendjen e tyre monetare *cash* në fund të vitit 2005 dhe në kohën e plotësimit të deklaratës së pasurisë nga ana e subjektit para fillimit të detyrës, në përgjigje të pyetësorit nr. 5, datë 18.05.2018, subjekti sqaron se:

- *Z. F. Sh, babai i subjektit, ka punuar mësues.*
- *Znj. Sh. Sh (F), nëna e subjektit, ka punuar në ish-NTSH Shijak dhe ka privatizuar një lokal ushqimor me sip. 38 m<sup>2</sup>, në të cilin kishte punuar, sipas kontratës nr. (\*\*\*) rep., (\*\*\*) kol., datë 06.11.1992, për të cilën ka paguar 60.487 lekë (bashkëlidhur dokumentet e privatizimit dhe të shitjes së dyqanit).*
- *Për blerjen e makinës kanë kontribuar prindërit në shumën 550.000 lekë, pjesë e parave të fituara nga shitja e dyqanit me kontratën nr. (\*\*\*) rep. (\*\*\*) kol., datë 07.12.1994 “Shitje lokali”, në vlerën 900.000 lekë, me blerës Z. F. Sh.*
- *Lidhur me gjendjen *cash* të prindërve në fund të vitit 2005 dhe në momentin e deklaramit para fillimit të detyrës, prindërit nuk e mbajnë mend për shkak të kohës që ka kaluar.*
- *Për Z. F. Sh ka dërguar vërtetimin për pagat neto për periudhën 1999 - 2001, gjithsej 696.339 lekë.*

Znj. Shehu ka paraqitur më datë 19.03.2018 një vërtetim të shoqërisë (“\*\*\*\*”) Shijak, ku nuk është përcaktuar se sa muaj në vit ka punuar subjekti, meqenëse ajo me kohë të pjesshme dhe nuk mund të llogariten se sa kanë qenë në total të ardhurat neto nga ky punësim. Duke qenë se për të ardhurat e përfituara nga subjekti si rrjedhojë e punësimit të saj me kohë të pjesshme pranë (\*\*\*) nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore, në mbështetje të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, këto të ardhura nuk konsiderohen pasuri të ligjshme.

*Pas verifikimeve të kryera nga Komisioni, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, krijohet bindja e brendshme se deklaramet e subjektit ishin përgjithësisht bindëse dhe të mjaftueshme.*

- ii) Llogari page pranë “BKT”-së, në emër të Znj. Marçela Shehu, në shumën 16.593, 07 (gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre lekë e shtatë qindarka)<sup>7</sup>.

*Përputhet deklarami i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e bankës “BKT”.*

---

<sup>7</sup> Shiko shkresën me nr.(\*\*\*) prot., datë 04.01.2018, drejtuar “BKT” sh.a. dhe përgjigjen me nr.(\*\*\*) prot., datë 23.01.2018, ku konfirmohet deklarami i subjektit.

iii) Depozitë kursimi për fëmijë:

- a) Në emër të (\*\*\*), me nr. llogarie (\*\*\*), pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 100.304,51 lekë, e hapur me kontratën e depozitës për fëmijë datë 10.10.2013, vlera fillestare e depozitës 20.154,52 lekë.<sup>8</sup>
- b) Në emër të (\*\*\*), me nr. llogarie (\*\*\*), pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 100.304,51 lekë, e hapur me kontratën e depozitës për fëmijë, datë 10.10.2013, vlera fillestare e depozitës 20.154,52 lekë.

*Subjekti ka deklaruar të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen depozitë të deklaruar për fëmijët.*

Z. S. H, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit të lidhur, deklaron:

1. Pasuri të paluajtshme e llojit “Shtëpi banimi”, me sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, kati i 4-t i një banese katërkatëshe, në proces legalizimi, me adresë: Njësia Bashkiake Nr. (\*\*\*), Rr. (\*\*\*), nr. (\*\*\*), Tiranë, në përdorim dhe jo në pronësi, së bashku me bashkëshorten Marçela Shehu, e cila ka deklaruar në faqen 5 që: “... në fillim proces legalizimi dhe pastaj ... edhe pas legalizimit të kësaj banese dhe regjistrimit në ZVRPP, unë nuk mund të figuroj si bashkëpronare”.

#### ❖ **Hetimi i kryer nga Komision**

Pasuria mbi të cilën është ngritur objekti që është në proces legalizimi figuron e regjistruar në ZVRPP Tiranë në emër të vjehrrit të subjektit, Z. B. H, dhe Z. Sh. H e Znj. L. B (H), pasuri e trashëguar.

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Tiranë<sup>9</sup>, rezulton se nuk figuron pasuri e regjistruar në emër të Znj. Marçela Shehu, Z. S. H, apo në emër të (\*\*\*), e (\*\*\*).

Nga korrespondenca e kryer me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t “Tirana-Veri”<sup>10</sup>, konfirmohet se Z. B. H figuron vetëdeklarues së bashku me Z. Sh. H, me nr. (\*\*\*), prot., datë 21.09.2006, ndërsa subjekti dhe personat e lidhur, sipas certifikatës familjare, nuk kanë objekte informale të deklaruara në proces legalizimi.

*Nga hetimi i kryer nga Komisioni, nuk ka dyshime mbi këtë pasuri. Përputhet deklarimi i personit të lidhur me subjektin me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.*

2. Llogari page pranë “Raiffeisen Bank”, me nr. llogarie (\*\*\*), në emër të S. H, me gjendje 1.995,28 (një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë lekë e njëzet e tetë qindarka).
3. Të ardhura nga paga neto pranë kompanisë “(\*\*\*),” periudha tetor 2006 - nëntor 2008, nga momenti i fillimit të detyrës së bashkëshortes si gjyqtare, gjithsej në vlerën 987.518 lekë.

<sup>8</sup>Shiko për më tepër shkresën me nr. (\*\*\*), prot., datë 04.01.2018, drejtuar “Raiffeisen Bank” dhe përgjigjen e ardhur më shkresën me nr. (\*\*\*), prot., datë 09.01.2018, ku konfirmohen depozitat e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit.

<sup>9</sup>Shiko shkresën me nr. (\*\*\*), prot., datë 04.01.2018, drejtuar ZVRPP Tiranë dhe përgjigjen e ardhur me shkresën me nr. (\*\*\*), prot., datë 19.01.2018, dhe shkresën me nr. (\*\*\*), prot., datë 23.01.2018, nga ku konstatohet se nuk ka pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

<sup>10</sup>Shiko në dosje shkresën me nr. (\*\*\*), prot., datë 04.01.2018, drejtuar ALUIZNI “Tirana – Veri” dhe përgjigjen e ardhur me nr. (\*\*\*), prot., datë 12.01.2018, (\*\*\*), prot., datë 08.03.2018, ku figuron Z. B. H, vjehri, në proces legalizimi.



4. Të ardhura neto nga paga pranë shoqërisë “(\*\*\*)” sh.a., për periudhën mars-2009 - gusht 2010, gjithsej në vlerën 1.193.756 lekë.
5. Të ardhura neto nga paga si punonjës pranë shoqërisë “(\*\*\*)” sh.a., me NIPT (\*\*\*) , gjithsej në vlerën 1.238.762 lekë.

*Nuk ka dyshime mbi këtë llogari bankare dhe për të dhënat mbi të ardhurat.*

6. Shpërblimi i personit të lidhur me subjektin, Z. S. H (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), në shumën 4000 euro, nga kompania “(\*\*\*)” sh.a. në vitin 2007.

Në deklaratën e interesave private (periodik/vjetor) të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, deklaroi pagën si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Tiranë, janar - nëntor 2007; pagën e bashkëshortit si punonjës tek “(\*\*\*)” shtator - dhjetor 2007, si dhe shpërblimin vjetor të marrë nga bashkëshorti nga shoqëria “(\*\*\*)” sh.a., në vlerën 4.000 euro (e aprovuar me dokument shoqëruar nga subjekti).

#### ❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Nga korrespondenca e kryer me shoqërinë “(\*\*\*)”<sup>11</sup> sh.a. në lidhje me këtë shpërblim të marrë nga Z. S. H, shoqëria sqaron se, duke qenë se ka kaluar një kohë shumë e gjatë (mbi 10 vjet), nuk kanë mundur të gjejnë dokumentacionin për këtë shpërblim. Për rrjedhojë, është e pamundur të konfirmohet nëse është dhënë apo jo ky shpërblim për Z. S. H. Konfirmohet gjithashtu se, në datën 17.08.2015 është nënshkruar kontrata për shitje aksionesh nga shitësi B. Rr te shoqëria “(\*\*\*)” sh.a., ku është përpiluar dhe deklarata noteriale, me anë të së cilës Z. Rr. garanton dhe merr përsipër çdo detyrim të lindur dhe që mund të lindë për llogari të shoqërisë “(\*\*\*)” sh.a., para kësaj date, përfshirë këtu edhe detyrimin ndaj institucioneve shtetërore, si dhe në rastin konkret ndaj Komisionit, për të konfirmuar apo vërtetuar nëse Z. S. H ka marrë shpërblim nga kjo shoqëri në vlerën 4.000 euro në fund të vitit 2007.

Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Ky shpërblim është marrë me një mandat arkëtimi, të cilin e disponojmë në fotokopje. Për të marrë origjinalin, i jemi drejtuar me një shkresë shoqërisë “(\*\*\*)” dhe na kanë konfirmuar se, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, nuk kanë mundur të gjejnë dokumentacion. Më kanë konfirmuar gjithashtu se tashmë aksionet e shoqërisë i kanë kaluar shoqërisë “(\*\*\*)”.*

Nga verifikimi i mandatpagesës së dërguar nga subjekti i rivlerësimit, që është një fotokopje me paqartësi, kemi shkrimin me germa kapitale (\*\*\*) (rezulton të jetë pak i grisur anash), mandat pagese nr. 310. Të dhënat e datës janë të padukshme. Te pjesa “*paguani Z.*” vazhdohet me emrin *S. H.*, me shkrim dore, te pjesa “*shuma lekë*” është shënuar me shkrim dore shuma 4.000 (katër mijë) euro. Përmbajtja e mandatpagesës në disa rreshta është e palexueshme dhe, në fund, është firmosur nga marrësi dhe arkëtari.

<sup>11</sup>Shiko për më tepër në dosje të Komisionit shkresat me nr.(\*\*\*) prot., datë 04.01.2018, shkresën me nr.(\*\*\*) prot., datë 08.02.2018, shkresën me nr. (\*\*\*) prot., datë 12.04.2018, drejtuar “(\*\*\*)” sh.a., si dhe përgjigjet e ardhura më datë 09.01.2018., nr. (\*\*\*) prot., datë 15.02.2018, nga “(\*\*\*)” sh.a.

Sqarojmë se Z. S. H ka punuar pranë kësaj shoqërie për periudhën 2005 - 2008.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, datë 11.05.2018, subjekti i rivlerësimit sqaron se: “Është e ndërgjegjshme në lidhje me vështirësinë e leximit të mandatpagesës për arsye se edhe vetë ajo e zotëron këtë dokument në fotokopje të vjetruar. Gjithsesi, në një shikim nga bashkëshorti, veç të tjerash, ai mund të shquajë si përshkrim të mandatit: “bonus për shitje, periudha 1 janar - 31 dhjetor” (llogaritje e përafërt)”.

### **Komisioni,**

Duke marrë në konsideratë korrespondencën e kryer me shoqërinë “(\*\*\*)” sh.a., deklaratimet dhe dokumentin e vënë në dispozicion nga subjekti, e konsideron të pamundur verifikimin dhe konfirmimin e vërtetësisë së mandatpagesës nr. 310, të vitit 2007, jo për faj të subjektit apo personit të lidhur me të. Për rrjedhojë, duke e konsideruar shteruese çdo korrespondencë dhe çdo mjet tjetër për verifikimin dhe konfirmimin e vërtetësisë së mandatpagesës nr. 310, viti 2007, në bazë të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, krijohet bindja e brendshme në lidhje me vërtetësinë e deklaratimit të shpërblimit prej 4.000 eurosh nga ana e personit të lidhur me subjektin, në deklaratën e interesave private (periodik/vjetor) të vitit 2007.

7. Transaksion i kryer për llogari të shoqërisë “(\*\*\*)” sh.a., në shumën 28.000 (njëzet e tetë mijë) euro.

DPPPP, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 10.05.2017, ndër të tjera konfirmon se në emër të personit të lidhur, Z. S. H, ka raportime të transaksioneve bankare, ku vlen të fokusohemi te transaksioni:

<b>Data</b>	<b>Banka</b>	<b>Nr. llogarie</b>	<b>Vleftha</b>	<b>Përshkrim</b>
20.11.2009	BKT	(***)	28.000 euro	Pagesë çeku AA (***) datë 20.11.2009. Burimi, “të ardhura nga biznesi”

### **❖ Hetimi i kryer nga Komisioni**

Kompania “(\*\*\*)” sh.a. informon Komisionin se: “Z. S. H ka qenë i punësuar pranë shoqërisë për periudhën mars 2009 - gusht 2010. Transaksioni i datës 20.11.2009 është kryer për qëllime të brendshme të aktivitetit të shoqërisë, shuma prej 28.000 eurosh është tërhequr pranë “BKT”-së dhe është depozituar brenda së njëjtës ditë, pranë “Intesa Sanpaolo Bank” nga një punonjës tjetër i shoqërisë<sup>12</sup>. Kopja e autorizimit në emër të Z. S. H nuk disponohet nga shoqëria, pasi transaksioni është i vitit 2009, por mund të gjendet në “BKT”. Z. H mund të ketë kryer edhe transaksione të tjera në emër të shoqërisë në cilësinë e punonjësit të saj. Bashkëlidhur nxjerrja e llogarisë nga “Intesa Sanpaolo”, datë 28.02.2018, ku rezulton në mënyrë të qartë depozitimi në cash nga Z. E. S, i shumës prej 28.000 eurosh të tërhequr nga “BKT”-ja në datën 20.11.2009.”

<sup>12</sup>Shiko shkresat me nr. (\*\*\*) prot., datë 21.02.2018, drejtuar “BKT”, me përgjigjen nr(\*\*\*)prot., datë 22.02.2018, dhe shkresa me nr. (\*\*\*) prot., datë 21.02.18, drejtuar shoqërisë “(\*\*\*)” sh.a., me përgjigjen me shkresën me nr. (\*\*\*) prot., datë 27.02.2018, ku konfirmohet ky transaksion për arsye pune.

“BKT” konfirmon dy veprime bankare të kryera nga Z. S. H, ku i pari është një tërheqje prej 6.900 eurosh nga llogaria e shoqërisë “(\*\*\*)” sh.a., në datën 19.03.2009, ndërsa i dyti është një pagesë çeku me nr. (\*\*\*), lëshuar nga kjo shoqëri, nëpërmjet të cilit Z. S. H ka tërhequr nga llogaria e shoqërisë në “BKT” shumën prej 28.000 eurosh, në datën 20.11.2009. Këto dy veprime bankare konfirmohen edhe nga lëvizjet bankare bashkëlidhur përgjigjes së “BKT”-së.

*Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka dyshime në lidhje me këtë transaksion*

## **8. Shpenzime për arsimim të personave të lidhur/fëmijëve**

Në lidhje me shpenzimet për shkollimin e fëmijëve, (\*\*\*) dhe (\*\*\*), pas korrespondencës së kryer nga Komisioni me shkollën jopublike “(\*\*\*)”<sup>13</sup>, me shkresën me nr. (\*\*\*) prot., datë 20.02.2018, ardhur përgjigje me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 27.02.2018, rezulton se subjekti ka të ardhura të mjaftueshme për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

*Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga shkolla jopublike “(\*\*\*)” për pagesat për arsim.*

## **9. Kontratë e lidhur nga Z. S. H, person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, me kompaninë OSHEE, për lidhje energjie elektrike.**

Nga korrespondenca e kryer me shoqërinë OSHEE, në lidhje me kontratat e lidhura për furnizimin me energji elektrike të subjektit si abonent familjar, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka kontratë me OSHEE-në për furnizim me energji elektrike.

Por, rezulton se Z. S. H ka kontratë energjie për njësinë “dyqan” me status “aktiv”. Nisur nga ky fakt, Komisioni ka kryer përsëri korrespondencë me OSHEE-në, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 05.04.2018, duke kërkuar informacion për kontratën që shtetasi S. H ka lidhur me OSHEE-në, për objektin “dyqan”, me adresë Rr. “(\*\*\*)”<sup>14</sup>.

Për sa më sipër, është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili ka përcjellë dokumentacionin justifikues dhe ka dhënë sqarimet përkatëse, si më poshtë:

*“Ky ambient nuk është as në pronësi, as në përdorim të S. H, bashkëshortit, por kontrata është e lidhur në emrin e tij, pasi pronarët e truallit, Z. B dhe Z. Sh. H, përkatësisht babai dhe xhaxhai i subjektit, kishin detyrime ndaj OSHEE-së dhe nuk mund të lidhnin kontratë. Ky ambient ishte në plan t’i jepej në përdorim shtetasit K. H për aktivitetet për tregtimin e qofteve, aktivitetet të cilin nuk e ka zhvilluar më pas. Bashkëshorti S. H as nuk e ka marrë dhe as nuk e ka dhënë me qira këtë ambient.”*

Këtë pretendim, subjekti e provon duke bashkëlidhur:

- a) deklaratë noteriale nga shtetasit B. H dhe Sh. H para noteres F. Sh, me nr. (\*\*\*) rep. kol., datë 14.04.2018, me anë të së cilës deklarojnë se Z. S. H (djali i B.) nuk e ka as në përdorim, as me qira ambientin “dyqan” në katin e parë të banesës 4-katëshe në Rr.

<sup>13</sup> Shiko në dosje të Komisionit, shkresën me nr. (\*\*\*) prot., datë 20.02.2018, drejtuar shkollës jopublike “(\*\*\*), ardhur përgjigje me shkresën me nr. (\*\*\*) prot., datë 27.02.2018.

<sup>14</sup> Shiko në dosjen e Komisionit, shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 17.01.2018, drejtuar OSHEE-së, përgjigjen me shkresat me nr. (\*\*\*) prot., datë 30.01.2018, dhe shkresën e OSHEE-së nr. (\*\*\*) prot., datë 27.04.2018.

“(\*\*\*))”, por për arsye se dy poseduesit e mësipërm kanë qenë debitorë me OSHEE-në, kontratën e ka lidhur shtetasi S. H, me kërkesë të tyre;

- b) deklaratë noteriale nga shtetasi K. H para noteres F. Sh, me nr. (\*\*\*)) rep. kol., datë 14.04.2018, me anë të së cilës deklaroi se ushtron aktivitet me objekt “prodhim e shitje qoftesh” me nr. NIPT (\*\*\*). Në vitin 2011 ka dashur të ushtrojë këtë aktivitet në një ambient në pronësi të shtetasve B. dhe Sh. H, duke iu kërkuar dhe hapjen e një kontrate për furnizim me energji elektrike (trefazor), për aktivitet tregtar, pasi deri në atë kohë ambienti ishte pa energji elektrike dhe, për këtë qëllim, u ka vënë në dispozicion dhe numrin e tij të NIPT-it. Marrja me qira e objektit nuk është realizuar për shkak se ambienti ishte i vogël e, për rrjedhojë, ka marrë me qira një ambient më të madh në po të njëjtën rrugë, ku vazhdon të ushtrojë aktivitetin e tij tregtar edhe sot, deklaruesi deklaroi se nuk ka lidhur asnjë kontratë qiraje me shtetasin S. H;
- c) Aplikimin për lidhje të re në Rr. “(\*\*\*))”, pranë kompanisë “CEZ Shpërndarje”, të datës 04.10.2011, ku konstatohet se aplikanti është konsumator privat me emër subjekti S. H, me nr. NIPTI (\*\*\*);
- d) Libreza për pagesën e energjisë elektrike për kontratën me nr. (\*\*\*), rezulton e lëshuar nga kompania “CEZ Shpërndarje” sh.a., në emër të Z. S. H;
- e) Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Person fizik” me nr. NUIS- (\*\*\*)) në emër të subjektit K. H, me datë regjistrimi 13.09.2010 dhe vend të ushtrimit të aktivitetit Rr. “(\*\*\*))”, Nr. (\*\*\*)) (ndërtesë 4 KT, kati (\*\*\*));

*Është pyetur përsëri subjekti i rivlerësimit në lidhje me pagesat e energjisë elektrike që rezultojnë të kryera në lidhje me këtë kontratë furnizimi.*

Në përgjigjen e saj, subjekti i rivlerësimit sqaron se Z. S. H nuk ka lidhur kontrata qiraje, huapërdorjeje etj., për periudhën nga viti 2011 e në vazhdim, për objektin me kontratë furnizimi me energji elektrike nr. (\*\*\*). Edhe prindërit e bashkëshortit, vëllai i tij dhe xhaxhai, kanë konfirmuar se nuk kanë lidhur ndonjë lloj kontrate për këtë objekt. Lidhja e kontratës për furnizimin me energji elektrike është bërë me mendimin potencial për ta shfrytëzuar për biznes e për ta dhënë me qira por, edhe pasi objekti nuk është dhënë me qira, nuk është parë e arsyeshme që të priset kontrata me OSHEE-në. Objekti është përdorur nga prindërit e bashkëshortit dhe vëllai i tij për punë të ndryshme familjare, madje gjatë ditës edhe për banim, prandaj është konsumuar energji elektrike dhe janë paguar faturat përkatëse.

#### ❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Nga korrespondenca e kryer me Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me çdo të dhënë të regjistruar në regjistrin noterial për shtetasin S. H rezultoi se, përveç veprimeve të tjera noteriale, nuk konfirmohet ndonjë transaksion i tipit kontratë dhurimi, qiraje, huapërdorjeje etj., për pasuri të paluajtshme, ku njëra palë të ketë qenë shtetasi S. H (shiko shkresën nr. (\*\*\*)) prot., datë 22.01.2018, të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë).

Me shkresën nr. (\*\*\*)) prot., datë 16.01.2018, QKB konfirmon se, veç të tjerëve, shtetasi S.H nuk figuron të jetë pajisur me NUIS (NIPT).

Në aplikimin për lidhje të re energjie elektrike në Rr. “(\*\*\*)”, pranë kompanisë “CEZ Shpërndarje”, të datës 04.10.2011, konstatohet se aplikanti është konsumator privat me emër subjekti S. H, me nr. NIPTI (\*\*\*), numër i cili sipas ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Person fizik” (kopje nga ueb) i korrespondon subjektit K. H.

*Pas verifikimeve të kryera nga Komisioni dhe deklarimeve të subjektit, rezultoi se deklarimi i subjektit është bindës dhe i mjaftueshëm.*

#### **10. Verifikime për përfshirje në biznes të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.**

Nga korrespondenca e kryer me Qendrën Kombëtare të Biznesit, konfirmohet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk figurojnë të pajisur me NUIS (NIPT) si person fizik apo të zotërojnë kuota aksionesh në shoqëritë tregtarësh (shiko shkresat nr. (\*\*\*) prot., datë 05.01.2018 dhe nr. (\*\*\*) prot., datë 15.01.2018).

#### **Rekomandimi për vlerësimin e pasurisë**

Sa më sipër, pavarësisht nga raporti i hollësishëm i dërguar nga ILDKPKI-ja, për të bërë një vlerësim të pasurisë së subjektit të rivlerësimit sa më objektiv dhe të paanshëm, është kryer hetim administrativ nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ, ka rezultuar se nuk ka dyshime mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe llogaritë e subjektit të rivlerësimit, përfshi dhe personave të lidhur me të. Po kështu, në të gjitha rastet e hetuara përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga institucionet shtetërore.

Nga analiza financiare rezulton se për periudhën 2004 - 2016 subjekti, me të ardhurat e fituara nga pagat e saj<sup>15</sup> dhe të bashkëshortit<sup>16</sup>, ka pasur burime të mjaftueshme për blerjen e pasurive të deklaruara, si dhe për shpenzimet e kryera.

*Në analizë të gjetjeve të mësipërme dhe nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrënë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.*

---

<sup>15</sup>Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, për periudhën 2004 - 2006; të ardhura nga paga si sekretare në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për periudhën 09.03.2004 - 01.10.2004; si gjyqtare në stazh në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën tetor 2006 - nëntor 2007; si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, për periudhën 14.11.2007 - 31.12.2016.

<sup>16</sup> Të ardhura nga paga e personit të lidhur Z. S. H, nga kompania “(\*\*\*)” sh.a., për periudhën 01.11.2005 - 01.11.2008, si dhe shpërbllim dhënë nga kjo kompania në vitin 2007 në shumën 4000 euro; të ardhura nga paga nga kompania “(\*\*\*)” sh.a., nr. (\*\*\*) , datë 02.09.2016, për periudhën mars 2009 - gusht 2010; të ardhura nga paga e personit të lidhur Z. S. H nga kompania (\*\*\*) – sh.a., për periudhën 01.12.2011 - 30.12.2016; të ardhura nga shitja e automjetit “Volkswagen” tipi “3BG Passat”, me targë (\*\*\*) , me kontratë shitblerjeje nr. (\*\*\*) rep., nr. (\*\*\*) kol., datë 24.06.2016, çmimi 5.000 (pesë mijë) euro.

## II. KONTROLLI I FIGURËS

### Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu”.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

### Rekomandimi për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

*Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si gjyqtare.*

## III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

### Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi vlerësimin e aftësive profesionale

Raporti për analizën e aftësive profesionale, i kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është bazuar te:

- Formulari i vetëdeklarimit, të 3 (tri) dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 (pesë) dosjet penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- Të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Nga kjo analizë konstatohet:

#### 1. Aftësitë profesionale

##### a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, gjyqtarja Marçela Shehu, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura prej saj dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

Tri dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe pesë dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë në të drejtën civile materiale.

Ajo ka njohuri edhe në të drejtën penale, ku kombinon mirë rregullat e pjesës së përgjithshme me ato të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Gjithashtu, ajo ka njohuri edhe në të drejtën procedurale penale. Nga ana tjetër, ndër 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, janë të ankimuar vetëm 2 prej tyre dhe në të dyja rastet, vendimi i dhënë nga gjyqtarja Marçela Shehu është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.

#### **b. Arsyetimi ligjor**

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, ka aftësitë e duhura në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

### **2. Aftësitë organizative**

#### **a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë**

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, në periudhën e rivlerësimit, 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Ajo ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim gjithsej 1386 çështje dhe ka përfunduar si kryesuese 1303 çështje, duke mbartur vitin e fundit 83 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 94 %.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, është efiçente dhe efektive. Ajo e respekton kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Në efektivitetin dhe efiçencën e veprimtarisë së saj ka ndikuar edhe ngarkesa sasiore. Në shumicën e rasteve, gjykimet kanë përfunduar brenda afateve të arsyeshme. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Gjithashtu, ajo i ka kushtuar rëndësi edhe kohës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

#### **b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore**

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.

Subjekti i rivlerësimit, zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës.

#### **c) Aftësia për të administruar dosjet**

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet

vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Gjithashtu, aktet procedurale janë të inventarizuara.

### **3. Etika dhe angazhimi profesional**

#### a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Marçela Shehu. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

#### b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo joshjeje apo presioni të jashtëm.

#### c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### a) Aftësia e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara është konstatuar se gjyqtarja Marçela Shehu komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

#### b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Znj. Marçela Shehu, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk është evidentuar asnjë rast, që të ketë pasur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, dështim të seancave të planifikuara apo vonesa në arsyetimin e vendimeve, që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

#### c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 12 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (shih të dhënat te trajnimet në 3 vitet e fundit). Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 17 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, të paorganizuar në seksione. Nuk dokumentohet që gjyqtarja Znj. Marçela Shehu të jetë angazhuar në aktivitete të tjera profesionale, jashtë Shkollës së Magjistraturës.



**1. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, bazuar në ankesat e subjekteve denoncues si më poshtë:**

**❖ Denoncimet nga publiku**

**Denoncimi 1.**

Me anë të denoncimit nr. (\*\*\*) prot., datë 05.12.2017, shtetasja Xh. M. J, denoncon subjektin e rivlerësimit Znj. Marçela Shehu, për korrupsion dhe zvarritje të proceseve gjyqësore.

Sipas denoncuesit, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. (\*\*\*), datë 14.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ka rrëzuar kërkesën e saj për përjashtimin e gjyqtarit, Z. D. M, nga gjykimi i çështjes civile të kundërshtimit të veprimit përmbarrimor.

*Pas shqyrtimit të denoncimit nga Komisioni, nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.*

**Denoncimi 2.**

Me anë të denoncimit nr. (\*\*\*) prot., datë 26.01.2018, shtetasi V. P denoncon subjektin e rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, për vendim të padrejtë, paaftësi profesionale dhe korrupsion.

Sipas denoncuesit, gjyqtarja Marçela Shehu është e korruptuar dhe nuk meriton të gjykojë, pasi ai po përjeton dënimin pasi është i varfër dhe “nuk ka pasur para t`i jepte gjyqtares”.

Denoncuesi nuk i ka bashkëlidhur prova konkrete denoncimit.

*Pas shqyrtimit të denoncimit nga Komisioni, nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.*

**Denoncimi 3.**

Me anë të denoncimit nr. (\*\*\*) prot., datë 02.03.2018, shtetasi M. Gj denoncon subjektin e rivlerësimit për proces jo të rregullt ligjor, zvarritje në proces dhe korrupsion.

Denoncuesi deklaron se ndodhet në një konflikt pronësie në lidhje me një pronë, e cila mbahet e zaptuar nga persona të tjerë me dokumente të falsifikuara dhe denoncon subjektin e rivlerësimit se me vendimin nr. (\*\*\*), datë 02.05.2017, të Gjykatës së Rrethit Kurbin, Znj. Marçela Shehu ka vendosur shpalljen e moskompetencës... dhe dërgimin e kësaj çështjeje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjithashtu, denoncuesi deklaron se gjykimi i kësaj çështjeje vazhdon nga data 16.03.2016 e në vijim dhe akoma nuk ka një vendim përfundimtar themeli.

Për denoncuesin, moszgjidhja e problemit i dedikohet neglizhencës së disa gjyqtarëve përfshirë dhe subjektin znj. Marçela Shehu.

*Pas shqyrtimit të denoncimit nga Komisioni, nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.*

#### ❖ **Ankesa ndaj subjektit të rivlerësimit në KLD**

KLD-ja, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 16.02.2018, informon Komisionin e Pavarur të Kualifikimit mbi ankesat në drejtim të subjektit të rivlerësimit për periudhën 01.01.2006 deri më sot, duke bashkëlidhur edhe praktikatat përkatëse si më poshtë:

- a) **Ankesa e shtetasit P. M, e vitit 2013;**
- b) **Ankesa e shtetasit P. N, e vitit 2016;**
- c) **Ankesa e shtetasit B. H, e vitit 2013;**
- ç) **Ankesa e shtetasit G. M, e vitit 2013;**
- d) **Ankesa e shtetasit M. Rr, e vitit 2017.**

*Pas shqyrtimit të denoncimeve të mësipërme nga Komisioni dhe konkluzioneve të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk ka indice për shkelje formale apo procedurale, si dhe nuk ka zvarritje të qëllimshme të gjykimit.*

#### ❖ **Ankesa të depozituara nga palë të treta në Ministrinë e Drejtësisë**

Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 05.04.2018 dhe (\*\*\*) prot., datë 26.03.2018, ka përcjellë pranë Komisionit praktikatat në lidhje me disa ankesa, si dhe trajtimet e bëra nga ky institucion si më poshtë:

- a) Ankesa e shtetasit A. B, nr. (\*\*\*) prot., datë 12.04.2012;
- b) Ankesa e shtetasit G. Z;
- c) Verifikim i informacionit të Prokurorit të Përgjithshëm;
- ç) Ankesa e shtetasit N. Sh (pritet përgjigjja nga KLD);
- d) Ankesa e shtetasve Gj. H dhe S. C (pritet përgjigjja nga KLD)

*Pas shqyrtimit të denoncimeve të mësipërme nga Komisioni dhe konkluzioneve të Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë në Ministrinë e Drejtësisë, nuk ka indice apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.*

- ❖ **Në lidhje me një denoncim në emisionin investigativ “(\*\*\*)”, në TV “(\*\*\*)”, më datë 07.10.2016, nga denoncuesi F. G, sipas të cilit gjyqtarja Marçela Shehu i dërgon fletëthirrje për paraqitje në gjykim shtetasit M. G, babai i denoncuesit, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2009, është kryer korrespondenca përkatëse me KLD-në.**

Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 09.05.2018, KLD informon Komisionin se nuk është paraqitur ndonjë ankesë në lidhje me rastin e cituar më lart, gjithashtu nuk rezulton ndonjë kërkesë për procedim disiplinor për subjektin e rivlerësimit në lidhje me rastin e mësipërm.

### **Rekomandimi për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit**

Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në gjetjet e mësipërme dhe pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe me kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

#### **a) Lidhur me aftësitë profesionale**

Subjekti i rivlerësimit, gjyqtarja Marçela Shehu, ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur prej saj në respektim të dispozitave procedurale penale. Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale, përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim. Ndërsa në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi çdo elementi të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale. Identifikon rastet kur norma ligjore plotësohet nga akte nënligjore. Sipas shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme, nr. (\*\*\*), datë 13.02.2018, për subjektin e rivlerësimit nuk ka masë disiplinore.

#### **b) Lidhur me aftësinë organizative**

Nga analiza e 5 çështjeve të përzgjedhura në short, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, është efiçente dhe efektive. Ajo e respekton kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Në shumicën e rasteve, gjykimet kanë përfunduar brenda afateve të arsyeshme. Gjithashtu, ajo i ka kushtuar rëndësi edhe kohës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

#### **Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale**

Subjekti i rivlerësimit, nisur nga rezultati i ankesave për këtë subjekt, verifikimi i tyre për periudhën e rivlerësimit, ka treguar angazhim dhe etikë në punë. Gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të gjyqtarit.

Nga shqyrtimi i dosjes për këtë subjekt nuk kanë rezultuar të dhëna në lidhje me ndikimin apo presion të jashtëm. Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 3 denoncime në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, të cilat nuk paraqesin indice për veprime të kryera që cenojnë integritetin apo përbëjnë gjetje për paanësinë e saj gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **c) Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional**

Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional rezulton se subjekti i rivlerësimit ka aftësi komunikimi dhe ka shprehur gatishmëri për t’u angazhuar në aktivitete profesionale.

Subjekti i rivlerësimit, gjyqtarja Marçela Shehu, i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 12 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

*Për sa më sipër, pas hetimit të raportit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe denoncimeve, nuk u gjet asnjë indice apo element që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarës, Znj. Marçela Shehu.*

## **SEANCA DËGJIMORE**

Duke qenë se subjekti i rivlerësimit u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në datën 25.04.2018, trupa gjykuese, në prani të përfaqësuesit të vëzhguesve ndërkombëtarë, Z. Theo Jacobs, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, në seancë dëgjimore në datën 01.06.2018, ora 10:00 paradite, në Sallën e Konferencave në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit. Znj. Marçela Shehu është njoftuar nëpërmjet komunikimit elektronik me *e-mail*, në datën 28.05.2018, për të cilin edhe ka komunikuar marrjen dijeni dhe nuk ka pasur pretendime apo kërkesa të tjera shtesë.

Në seancën dëgjimore të datës 1 qershor 2018, subjekti i rivlerësimit u paraqiti dhe u mbrojti personalisht. Znj. Marçela Shehu nuk paraqiti pretendime të reja shtesë, deklaroi se ishte dakord me rezultatet e hetimit dhe kërkoi rikonfirmimin në detyrë.

### **VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se:

**Së pari**, trupa gjykuese mori në analizë kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të ILDKPKI-së, konkluzionet e nxjerra pas hetimit, informacionet e kërkuara nga subjektet e së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 dhe pretendimeve dhe provave të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit.

Në procesin e rivlerësimit të subjektit përfshihet kontrolli i pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. ILDKPKI-ja kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, si dhe për saktësinë e deklaramit.

Referuar nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm e të arsyetuar dhe, sipas rastit, konstaton se: a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; është kryer fshehje e pasurisë; është kryer deklarim i rremë; subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Neni 33 i ligjit, ndër të tjera, parashikon se Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, për qëllimet e rivlerësimit, mund të kërkojë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ose Ministrisë së Drejtësisë dokumentet për pasuritë në pronësi të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, dokumentet që përdoren jashtë shtetit nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, ose të dhënat financiare mbi çdo transaksion financiar brenda ose jashtë vendit në përputhje me ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta. Këto dokumente ose informacione mund të përdoren në cilësinë e provave përpara Komisionit ose Kolegjit të Apelit.

Vetë Kushtetuta i ka njohur ILDKPKI-së kompetencën për realizimin e procedurës së kontrollit të deklaratës dhe përgatitjen e raportit të hollësishëm në lidhje me ligjshmërinë e pasurive, saktësinë dhe plotësinë e deklarimit. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kushtetutëbërësi ka përcaktuar qartësisht organin që do ta kryejë procedurën e kontrollit të deklaratës dhe kompetencat e këtij organi, të cilat janë specifikuar më tej në ligjin nr. 84/2016. Edhe pse ligji ka parashikuar në mënyrë më të detajuar kompetencat e ILDKPKI-së dhe rolin e saj konkret në këtë proces, nuk rezulton që ato bien ndesh me kompetencën kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe as e cenojnë në thelb atë<sup>17</sup>.

Hetimi administrativ i thelluar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratave në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, fshehje të pasurisë, deklarim të rremë apo konfliktin e interesit, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

Ky hetim është përqendruar, mbi të gjitha, te pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu.

**Së dyti**, trupa gjyquese mori në analizë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, raportin e arsyetuar të DSIK-së mbi pastërtinë figurës së subjektit të rivlerësimit.

Referuar nenit 35/2 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja menjëherë ka filluar procedurën e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, e cila ka plotësuar formularin përkatës. DSIK-ja, pasi ka kryer procedurën e kontrollit të figurës së subjektit, sipas parashikimeve të neneve 34 deri në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe ka përfunduar kontrollin për figurën e subjektit të rivlerësimit, ka dërguar raportin përfundimtar, sipas të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të gjyqtares Marçela Shehu.

Komisioni, pasi ushtroi të drejtën e kontrollit të pastërtisë së figurës të subjektit të rivlerësimit, konstatoi se nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

---

<sup>17</sup>Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017

**Së treti**, trupa gjykuese mori në analizë vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, konkluzionet e nxjerra pas hetimit të denoncimeve.

Në përfundim të kësaj analize, nuk u gjet asnjë indice apo element që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarës, Znj. Marçela Shehu.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Znj. Marçela Shehu, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### **ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Kryesues**

**Olsi KOMICI**  
**Relator**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Anëtar**

**Sekretare gjyqësore**  
**Denisa KOSTA**

